

URDHËR
Nr. 269, datë 28.8.2020

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE
PARAUNIVERSITARE PRIVATE “KASA”, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26 dhe 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private “Kasa”, Durrës, për të gjitha nivelet arsimore (parashkollor, arsimi fillor, arsimi i mesëm i ulët dhe arsimi i mesëm i lartë i përgjithshëm), në emër të shoqërisë “Kasa” sh.p.k., përfaqësuar nga z. Jonuz Kasa, i regjistruar si person juridik me vendimin nr. 6299/2, datë 15.9.1994, të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

2. Institucionet arsimore parauniversitare private “Kasa”, Durrës, kanë këto detyrime:

a) Të kthejnë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur, nëse ka.

b) Të pajisin çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar.

c) Të vënë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër.

d) Të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri.

e) Të dorëzojnë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhen institucionet arsimore parauniversitare private “Kasa”, ka për detyrë:

a) Të ngrejë grup pune brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private “Kasa”, Durrës, për të gjitha nivelet arsimore (parashkollor, arsimi fillor, arsimi i mesëm i ulët dhe arsimi i mesëm i lartë).

b) Të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këto institucione arsimore.

c) Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga këto institucione arsimore parauniversitare private.

d) Të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dokumentacionin e dorëzuar nga institucionet arsimore parauniversitare private “Kasa”.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast moszbatimi të detyrimeve, përcaktuar në pikën 2, nga personi juridik që përfaqëson institucionin arsimor parauniversitar privat “Kasa”, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 44, datë 13.2.2007, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar: - Shkolla nëntëvjeçare “Kasa”, urdhri nr. 15, datë 17.1.2008, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për funksionimin e institucionit arsimor privat

parauniversitar: - Kopshti "Kasa" dhe urdhri nr. 14, datë 17.1.2008, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar: - Shkollë e mesme e përgjithshme "Kasa", shfuqizohen.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullore dhe e Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Durrës, institucionet arsimore parauniversitare private "Kasa", Durrës dhe shoqëria "Kasa" sh.p.k.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini